



Të kuptoni certifikatën e sigurimeve të pensionit (certificat de prévoyance)

Kjo fletë udhëzuese ju paraqet, sesi është ndërtuar një certifikatë e sigurimeve të pensionit. Ajo jep sqarime dhe përmban informacione të dobishme për tema të rëndësishme.

Paragrafët me numra u referohen secili seksioneve në modelin e certifikatës së sigurimeve të pensionit. Ju lutemi vini re, që modeli i certifikatës së sigurimeve të pensionit mbulon të gjitha zgjidhjet për pension të fondacioneve kolektive, të drejtuara nga Swiss Life. Nëse keni pyetje konkrete për zgjidhjen tuaj për pension, përcaktimet i gjeni në rregulloren e sigurimeve të pensionit.

1 Të dhëna të përgjithshme (Données générales)

Këtu tregohen të dhënat mbi kontratën dhe personin tuaj. **Paga vjetore e deklaruar (salaire annuel annoncé)** si rregull përkon me pagën vjetore AHV të deklaruar nga punëdhënësi juaj dhe duhet të përputhet me pagën tuaj vjetore efektive (paga bruto sipas vërtetimit të pagës).

Paga vjetore duke hequr zbritjen e koordinimit jep pagën e siguruar. Zbritja e koordinimit shërben për koordinimin me kolonën e parë (Sigurimet e detyrueshme federale për pension pleqërie dhe për pension për persona të lënë pas AHV).

2 Depozita e pleqërisë (Avoir de vieillesse)

Depozita juaj **ekzistuese e pleqërisë (avoir de vieillesse)** llogaritet me ditë të sakta dhe është e vlefshme për datën e lëshimit. Ajo përmban kontributet vjetore të kursimit, shumat e kalimit të lirë të transferuara, interesat si edhe blerjet dhe kontribute të çfarëdo lloji tjetër (p.sh. tepricat).

Nëse ndërpritni marrëdhëniet tuaja të punës, ju gëzoni **të drejtën e kalimit të lirë (droit à la prestation de libre passage)**. Shuma i përcillet institutit të sigurimeve të punëdhënësit tuaj të ri. Mundësitë për rastin që nuk filloni një punë të re, i gjeni në fletën udhëzuese «Austritt» (Dalja) nën linkun te certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

Për pagesën e interesit për paratë tuaja të sigurimeve të pensionit vlejnjë normat e interesit të dhëna te certifikata juaj. Normat e interesit për pjesën e detyrueshme përcaktohen çdo vit nga Kuvendi Federal, pagesa e interesit për shumën e depozituar mbi pjesën e detyrueshme përcaktohet – sipas zgjidhjes për pension – nga këshilli i fondacionit ose nga komisioni administrativ.

3 Përfitimet në moshën e pensionit (Prestations de vieillesse)

Kur dilni në pension, si rregull keni mundësi zgjedhjeje midis pensionit të pleqërisë që zgjat gjithë jetën, derdhjes njëherësh të të gjithë kapitalit të grumbulluar ose një kombinimi të të dyjave.

Ju shikoni **kapitalin (capital)** e parashikuar ose **pensionin (rente)** e parashikuar në momentin e daljes së rregullt në pension ose në momentin e daljes së parakohshme në pension. Kapitali i parashikuar llogaritet me përafërsi me të dhënat që njihen sot (depozita ekzistuese e pleqërisë, paga e siguruar, kontributet vjetore për pension pleqërie dhe kohëzgjatja e sigurimit deri në dalje në pension). Interesi i projektimit i përdorur për llogaritjen e përafërt orientohet sipas normës efektive të interesit të shumëzës së depozituar për pension pleqërie në vitet e fundit dhe po ashtu është i shënuar në certifikatë. Kapitali përbën bazën për llogaritjen e pensionit të pleqërisë.

Norma e konvertimit është vendimtare për vlerën e pensionit. Pensioni llogaritet nga shumëzimi i kapitalit me normën e konvertimit. Në rastin e lënies së parakohshme të punës, norma e konvertimit zvogëlohet dhe për pasojë edhe pensioni. Pensionin e pleqërisë ju e merrni pas daljes në pension deri në fund të jetës suaj.

Veç pensionit të pleqërisë jepen edhe **pensionet e fëmijëve të personit në pension (rente pour enfant de personne retraitée)**, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve për pensionin. Një pension për fëmijë ju e merrni pas daljes suaj në pension për çdo fëmijë të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç). Gjithashtu janë të siguruar edhe përfitimet për personat e lënë pas për bashkëshortët/partnerët bashkëjetues dhe fëmijët.

4 Financimi i daljes së parakohshme në pension (Financement de la retraite anticipée)

Në rast se vendosni për të dalë para kohe në pension, këtu shikoni maksimumin e mundshëm të *Shumës së blerjes për një pension të parakohshëm (versement supplémentaire pour une retraite anticipée)*. Duke derdhur këtë shumë, mund të siguroheni, që edhe në rast të daljes para kohe në pension të merrni pensionin e plotë. Ju lutemi vini re, që këto informacione dalin vetëm pas shfrytëzimit të plotë të pjesës së mbetur të potencialit tuaj të blerjes (shikoni Nr. 7).

5 në rast invaliditeti (Prestations en cas d'invalidité)

Ju e merrni të plotë *pensionin vjetor të invaliditetit (rente annuelle d'invalidité)* kur, sipas sigurimit federal të invaliditetit, jeni invalid të paktën në masën 70% dhe afati i pritjes ka skaduar.

Në rastin e invaliditetit të pjesshëm, shumat e përfitimeve të invaliditetit përcaktohet duke marrë në konsideratë shkallën e invaliditetit sipas rregullores së sigurimeve të pensionit. Përfitimet fillojnë tashme nga shkalla e invaliditetit prej 25%.

Për çdo fëmijë ju merrni të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç) një *pension për fëmijën e personit invalid (rente pour enfant d'invalidité)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

Çlirim nga detyrimi i pagesës së kontributeve (L'exonération des cotisations) do të thotë, që ju dhe punëdhënësi juaj, në rastin e invaliditetit dhe pas skadimit të afatit të pritjes, nuk duhet të paguani më asnjë kontribut. Përfitimet tuaja të pensionit të pleqërisë, të pensionit për personat e lënë pas dhe të pensionit të invaliditetit vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën masë.

6 Përfitimet në rast vdekjeje para daljes në pension (Prestations en cas de décès avant la retraite)

Në rastin e vdekjes së personit të siguar, për personin bashkëjetues dhe partnerin homoseksual janë të vlefshme të njëjtat kushte si për çiftet e martuara dhe të regjistruara, nëse jetesa së bashku në një shtëpi ka ekzistuar të paktën për pesë vjetet e fundit përpara vdekjes së personit të siguar dhe nëse duhet kujdesur për fëmijët e përbashkët. Vendimtare janë përcaktimet e rregullores së sigurimeve të pensionit të vlefshme në momentin e vdekjes. Në vend të *pensionit të bashkëshortit ose të partnerit (rente de conjoint ou de partenaire)*, bashkëshorti juaj ose personi juaj bashkëjetues mund të kërkojë marrjen e plotë ose të pjesshme të kapitalit.

Çdo fëmijë me të drejtë përfitimi merr të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri

në moshën 25 vjeç) një pension *për fëmijët jetimë (rente d'orphelin)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

7 Blerja dhe kthimet (Rachat et remboursements)

Shumica e personave të siguar zotërojnë një potencial për blerje në shtyllën e dytë. Me këtë arrini përfitimet më të larta ose ndoshta maksimale nga sigurimet e pensionit. Vini re, që blerjet mund të kryhen, sipas ligjit, vetëm kur janë kthyer tërheqjet e parakohshme për pronësinë e banesës.

Informacione të tjera të dobishme për *Blerjen dhe kthimet (le rachat et les remboursements)* dhe kushtet e përgjithshme ligjore i gjeni në fletën udhëzuese «Einkauf» (Blerja) nën linkun të certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

8 Financimi (Financement)

Me punëdhënësin tuaj financoni përfitimet e siguruara. Punëdhënësi juaj e zbret kontributin tuaj mujor nga paga juaj bruto. Diferencën me totalin e paguan punëdhënësi juaj.

Kontributi i kursimeve (cotisation d'épargne) (pjesa e kontributit për përfitimet e pleqërisë) ndikon direkt mbi depozitën e pleqërisë. Me *Kontributet për rreziqet (cotisations de risque)* do të financohen përfitimet e siguruara në rast invaliditeti dhe vdekjeje.

9 Informacione të përgjithshme (Données générales)

Tërheqja e parakohshme maksimalisht e mundshme për pronësinë e banesës (montant maximum disponible pour la propriété du logement) përkon deri në moshën 50 vjeç me të drejtën përkatëse të kalimit të lirë. Pas kësaj moshe, mund të tërhiqet ose gjysma e së drejtës aktuale të kalimit të lirë, ose e drejta e kalimit të lirë për moshën 50 vjeçare, në varësi se cila shumë është më e madhe.

10 Komisioni administrativ (Commission de gestion)

Pjesëtarët e komisionit administrativ marrin përsipër në mënyrë të veçantë vënien në zbatim të rregullores së sigurimeve për pensionin, informimin e personave të siguar dhe zgjedhjen e pjesëtarëve të këshillit të fondacionit.

11 Shënime (Remarques)

Informacione të mëtejshme, në mënyrë të veçantë rregulloren e sigurimeve të pensionit dhe kushtet e vlefshme aktuale, i gjeni nën linkun e dhënë. Pyetjet tuaja në lidhje me sigurimet të pensionit mund t'i diskutoni direkt me këshilltarin tuaj për klientin, dhe ai është i gatshëm t'ju këshillojë me kënaqësi.

Modèle du certificat de prévoyance 2019: recto

Fondation collective LPP, Swiss Life
Société Modèle SA, Modèleville



CH/UXX-PXSX / XXXXXX / 756.XXXX.XXXX.XX

Personnel/Confidentiel

Madame
Sabine Modèle



Certificat de prévoyance personnel

Valable à partir du 01.02.2019

À l'attention de Madame Sabine Modèle

Motif d'établissement : Réception de la prestation de libre passage

Partie active

Tous les montants sont en CHF

| | | | | |
|---|---|-----------------------------------|------------|-----------|
| ① Données générales | Contrat XXXXXX | Salaire annuel annoncé | 45'480.00 | |
| | Group de personnes 001 | Salaire considéré, partie épargne | 33'142.50 | |
| | Effectif général | Salaire considéré, partie risque | 45'480.00 | |
| | No d'assuré 756 XXXX.XXXX.XX | | | |
| | Date de naissance 28.03.1961 | | | |
| | Taux d'occupation de 50.00% | | | |
| ② Avoir de vieillesse | | Partie obligatoire | Total | |
| | Avoir de vieillesse disponible au 01.01.2019 | 13'352.10 | 76'057.65 | |
| | Intérêts crédités du 01.01.2019 au 01.02.2019 | 13.90 | 53.15 | |
| | Versement (Prestation de libre passage) 01.02.2019 | 0.00 | 75'900.65 | |
| | Bonification de vieillesse du 01.01.2019 au 01.02.2019 | 312.10 | 497.15 | |
| | Avoir de vieillesse au 01.02.2019 | 13'678.10 | 152'508.60 | |
| | Droit à la prestation de libre passage au 01.02.2019 | 13'678.10 | 152'508.60 | |
| | Taux d'intérêt valable pour la période concernée | | | |
| | • partie obligatoire | x.xxx% | | |
| | • partie subrogatoire | x.xxx% | | |
| ③ Prestations de vieillesse | | Capital | ou | Rente |
| | À l'âge de 64 ans au 01.04.2025 | 206'774.75 | | 11'201.25 |
| | À l'âge de 63 ans au 01.04.2024 | 197'355.40 | | 10'363.90 |
| | À l'âge de 62 ans au 01.04.2023 | 188'098.00 | | 9'589.80 |
| | À l'âge de 61 ans au 01.04.2022 | 178'999.90 | | 9'102.60 |
| | À l'âge de 60 ans au 01.04.2021 | 170'058.25 | | 8'658.80 |
| | À l'âge de 59 ans au 01.04.2020 | 161'270.35 | | 8'253.10 |
| À l'âge de 58 ans au 01.04.2019 | 153'704.90 | | 7'911.60 | |
| | Autres prestations à la retraite (en pourcentage de la prestation de vieillesse perçue sous formes de rentes) | | | |
| | • Rente pour enfant de personne retraitée 20% | | | |
| | • Rente de conjoint/de partenaire en cas de décès après le départ à la retraite 60% | | | |
| | • Rente d'orphelin en cas de décès après à la retraite 20% | | | |
| | Taux d'intérêt supposé pour le calcul des prestations de vieillesse (non garantie) : x.xxx% | | | |
| | Les taux utilisés pour la conversion de l'avoir de vieillesse en une rente ainsi que les taux d'intérêt en vigueur actuellement se trouvent sous www.swisslife.ch/fr/protect/ | | | |
| ④ Financement de la retraite anticipée | Versement supplémentaire pour une retraite anticipée | | Maximum | |
| | A l'âge de 63 au 01.02.2024 | | 15'357.55 | |
| | A l'âge de 62 au 01.02.2023 | | 30'737.60 | |
| | A l'âge de 61 au 01.02.2022 | | 40'323.65 | |
| | A l'âge de 60 au 01.02.2021 | | 49'105.70 | |
| | A l'âge de 59 au 01.02.2020 | | 57'128.00 | |
| A l'âge de 58 au 01.04.2019 | | 64'056.70 | | |
| | En ce qui concerne le financement, nous vous renvoyons au règlement de prévoyance. | | | |

Modèle du certificat de prévoyance 2019: verso

Contrat XXXXXX No d'assuré 756.XXXX.XXXX.XX
Madame Sabine Modèle, Date de naissance 28.03.1961

Tous les montants sont en CHF

| | | Accident | Maladie |
|--|--|------------------------------|-----------------|
| 5 Prestations en cas d'invalidité | Rente annuelle d'invalidité (délai d'attente de 24 mois) | 0.00 | 15'918.00 |
| | Rente annuelle pour enfant d'invalidé (délai d'attente de 24 mois) | 0.00 | 502.20 |
| | Exonération des cotisations (délais d'attente de 3 mois) | | |
| | Les prestations indiquées correspondent à un degré d'invalidité de 100% | | |
| Les prestations en cas d'invalidité sont payables au maximum jusqu'au 31.03.2025. | | | |
| 6 Prestations en cas de décès avant la retraite | Rente annuelle de conjoint/partenaire | 0.00 | 1'506.55 |
| | Rente annuelle d'orphelin | 0.00 | 502.20 |
| | Capital décès en plus d'une rente de conjoint/partenaire | 152'508.60 | 119'333.25 |
| | Capital décès, si aucune rente de conjoint/partenaire n'est due | 152'508.60 | 152'508.60 |
| 7 Rachat / Remboursement | Total versement possible au 01.02.2019 | 0.00 | 0.00 |
| | • Part de remboursement du versements anticipé pour la propriété du logement | 0.00 | 0.00 |
| | • Part de remboursement consécutif à un divorce/dissolution du partenariat enregistré | 0.00 | 0.00 |
| | • Part de rachat dans la caisse de pension | | 0.00 |
| | Les versements anticipés pour la propriété du logement sont à rembourser avant un rachat. | | |
| 8 Financement | Cotisation d'épargne | Employé 2'971.20 | Total 5'942.40 |
| | Cotisations de risque, coûts et cotisations additionnelles ordonnées | 622.80 | 1'245.60 |
| | Cotisation annuelle | 3'594.00 | 7'188.00 |
| | Cotisation mensuelle 1/12 | 299.50 | 599.00 |
| 9 Données générales | Prestation de libre passage à l'âge de 50 ans | Partie obligatoire | Total 50'723.55 |
| | Montant maximum disponible pour la propriété du logement au 01.02.2019 | | 50'723.55 |
| | Mise en gage pour la propriété du logement : non | | |
| 10 Commission-de gestion | Président/présidente Jean Dupont, Modèleville | Représentants de l'employeur | |
| | Représentants des salariés | Jean Dupont, Modèleville | |
| | Max Modèle, Modèleville | | |
| 11 Remarques | Vous trouverez les conditions légales ainsi que d'autres informations utiles sous www.swisslife.ch/fr/protect/ | | |
| | Les valeurs mentionnées se basent sur les hypothèses actuellement en vigueur et ont un caractère purement informatif. | | |
| | S'agissant de l'échéance et du droit aux prestations, nous vous renvoyons à votre règlement de prévoyance et au plan de prévoyance sur lequel se base le présent certificat. | | |
| | Monsieur/Madame Prénom, Nom de famille se tient à votre disposition au 043 284 XX XX, pour tout renseignement complémentaire. | | |
| Votre prévoyance en ligne | Le portail en ligne vous permet de consulter vos données et de planifier votre avenir en ligne. | | |
| | Inscrivez-vous dès aujourd'hui sur myworld.swisslife.ch et bénéficiez de nos prestations | | |
| Etabli par Swiss Life le 15.01.2019 sur mandat de votre institution de prévoyance. | | | |